



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2085/10 prot

Datë 12.08.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1026/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.08.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1001/2024, datë 05.08.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-13603-07-18-2024, me objekt: *Loti III “Blerje Letër”* me fond limit 28,003,442 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 19.08.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Marketing&Distribution” SHPK, me NUIS J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Rruga Iliria, Nr. 53, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.3, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 05.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1001/2024, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Marketing&Distribution” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-13603-07-18-2024, me objekt: Loti III “Blerje Letër” me fond limit 28,003,442 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 19.08.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën sipas konstatimeve të KSHA-së, me vendimin e dhënë me nr. 894/11 prot., datë 30.07.2024.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Marketing&Distribution” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Në datën 09.08.2024 është protokolluar në KPP me nr. 2085/7 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, nr. 895/16 prot., datë 08.08.2024 me anë të së cilës AK njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1001/2024, datë 05.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-13603-07-18-2024, me objekt: *Loti III “Blerje Letër” me fond limit 28,003,442 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 19.08.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Në datën 09.08.2024 është protokolluar në KPP me nr. 2085/7 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, nr. 895/16 prot., datë 08.08.2024 me anë të së cilës AK njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1001/2024, datë 05.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-13603-07-18-2024,

me objekt: *Loti III "Blerje Letër"* me fond limit 28,003,442 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 19.08.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ky verifikim rezultoi se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 1001/2024, datë 05.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke publikuar shtojcën sipas konstatimeve të KSHA-së me vendimin e dhënë me nr. 894/11 prot., datë 30.07.2024.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr. REF-13603-07-18-2024, me objekt: *Loti III "Blerje Letër"* me fond limit 28,003,442 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 19.08.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

